



U R D H Ë R

Nr. 111, datë 10.09.2020

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

U R D H Ë R O J:

1. Struktura e Agjencisë Kombëtare të Diasporës të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Agjencisë Kombëtare të Diasporës të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës të jetë, gjithsej, 16 veta.
4. Urdhri nr. 53, datë 16.03.2018, i Kryeministrit. “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA